

RELACION JOTEKNIK

***(Per kryerjen e degjeses me publikun, ne zbatim te VKM Nr. 419, date 25.06.2014,
Kreu VI “INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT PËR APLIKIMIN
PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A DHE B”)***

Person Fizik: Ramazan Bodlli

Aktiviteti: Menaxhimi i mbetjeve, sipas specifikimeve me ID 5.5; ID 5.8; ID 5.10 b

**Vendodhja: Lagjja Nr. 13, Plazh, Durres, Zona Kadastrale 8518, Pas.Nr.
16/177**

HYRJE

Personi Fizik Ramazan Bodlli, me NIPT - K31629521A, i regjistruar me date 01/01/2003, ushtron aktivitetin “Autoservis. Tregtim, montim, pjese kembimi dhe grumbullim skrap. Parking dhe tregtim automjetesh me ndermjetesim”.

Per kete aktivitet, eshte pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me Nr 373 Prot, date 03.09.2019.

Per shkak te ndryshimeve ligjore si dhe bazuar ne:

- ligjin nr.10448, datë 14. 7. 2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- VKM Nr. 419, date 25.06.2014, e ndryshuar
- ligjin nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;

zhvilluesi do t’i nenshtrohet procedures per t’u pajisur me Leje Mjedisore Tipi B.

Aktiviteti kryhet ne fushen e “Menaxhimit te mbetjeve”, me:

ID 5.5. Magazinim i hekurishteve/skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme, - Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Kapaciteti I barabartë me 50 ton/ditë ose më I madh se kaq

ID 5.8 Magazinim, rikuperim I hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave, - **Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B:** Të gjitha instalimet.

ID 5.10 b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmenden më lart, - Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Kapaciteti I barabartë me 50 ton/ditë ose më I madh se kaq.

a) **Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.**

Aplikimi do te kryhet per Leje Mjedisi Tipi B, ne baze te:

- ligjin nr.10448, datë 14. 7. 2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- VKM Nr. 419, date 25.06.2014, e ndryshuar
- ligjin nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;

b) **Të dhënat e ekstraktit të OKR-së:**

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)
K31629521A
2. Emri i subjektit RAMAZAN BODLLI
3. Forma ligjore Person Fizik
4. Data e regjistrimit 01/01/2003
5. Fusha e veprimtarisë Autoservis. Tregtim, montim, pjese kembimi dhe grumbullim skrap.Parking dhe tregtim automjetesh me ndermjetesim.
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit Durres Durres DURRES L.13, PLAZH
7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit
8. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht Emri Tregtar: RAMAZAN BODLLI
E-Mail: ramazanbodlli@yahoo.com
Telefon: 0695623144
9. Statusi Aktiv

c) **Adresën e vendndodhjes së instalimit;**

Aktiviteti kryhet ne vendodhjen me adrese:

DURRES L.13, PLAZH, Zona Kadastrale: 8518, Pasuria: 16/177

c) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;

Aktiviteti kryhet ne fushen e “Menaxhimit te mbetjeve”, me:

ID 5.5. Magazinim i hekurishteve/skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te rrezikshme,

- Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Kapaciteti I barabartë me 50 ton/ditë ose më I madh se kaq

ID 5.8 Magazinim, rikuperim I hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave, - Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet.

ID 5.10 b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmenden më lart, - Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Kapaciteti I barabartë me 50 ton/ditë ose më I madh se kaq.

d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;

Per zhvillimin e ketij aktiviteti jane te domosdoshme pajisjet e meposhtme:

1. Peshore
2. Seleksionues
3. Prese

e) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;

Zhvillimi I Aktivitetit nuk prek zona kufitare

ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;

Procedurat, vendimarrja, afatet ndiqen ne zbatim te VKM 419/2014, e ndryshuar.

f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

info@akm.gov.al

Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;

a) Pershkrim i shkurtër i mbuleses bimore te sipërfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me foto

Mbulesa bimore ne kete zone nuk eshte e zhvilluar sic mund te duket qarte edhe nga ortofoto apo fotot ne terren ku duket qarte mungesa e mbuleses bimore ne kete zone.

Zona e fshatit Tragjas vitet e fundit eshte kthyer ne nje zone ndertimesh te objekteve kryesisht me funksion biznesi, si makazina, krijimi i serrave per mbjellje te produkteve bujqesore apo edhe biznese te tjera te llojeve te ndryshme. Eshte nje zone e favorshme per ndertim pasi ndodhet jo shume larg qytetit gje qe i jep mundesi investitorit te kurseje edhe kosto transporti per materiale ose force punetore.

Vegjetacioni qe takohet ne kete zone kodrinore dhe fushore eshte tipik i mjediseve te ulta bregdetare, anash rrjedhjeve ujore-kanaleve kullues te tokave bujqesore. Karkteristika e pare e tij eshte plasticiteti i larte ekologjik i shoqerimeve qe pasqyrohet qarte ne perberjen floristike te tij. Ne brigjet e lumit Ishem qe ndodhet larg zones me rreth 1.3km dhe tributareve llojet shoqeruese me vlera te larta te sasi-mbuleses perfaqesohen nga: Typha latifolia, Lythrum salicaria, Cladium mariscus, alisma plantago-aquatica, Sparganium erectum etj. Flora e habitatit te marre ne konsiderate (Toka te punuara) eshte e varfer ne lloje dhe monotone. Hapesira paraqitet e ekspozuar ndaj rezatimit te diellit. Numri i llojeve ketu eshte i ulet dhe ato jane direkt te kercenuara nga veprimtaria e njeriut. Duhet te nenvizojme faktin se perdorimi i pesticideve dhe herbicideve per nje kohe te konsiderueshme ka afektuar ndjeshem larmine biologjike te territorit te mare ne konsiderate. Nga familjet me te takueshme, me nje numer me te madh bimesh jane: Compositae, Graminae, Leguminosae, Cruciferae, Papaveraceae, Poligonaceae, Convolvulaceae dhe Primulaceae. Lloji me i dendur ne mbi 40% te nje rilevimi shume te shpejte eshte Papaver rhoeas dhe me pas permendim llojet: Avena sterilis, Lactica seriola, Alopecurus myosuroides, Sinapis arvensis, Capsella bursa-pastoris, Sonchus vulgaris, Anagalis arvensis, Madicago lupulina etj



X - 41°18'54.41"N

Y - 19°28'43.89"E

b) Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj

Zona ne pikpamje te infiltrueshmerise karakterizohet nga grupime shkembinjsh dhe dherash: zhavorre proluviale, suargjila deluviale, shkembinjte argjilo-alevrolitiko-ranore te Neogjenit (N3/1t) Nga vrojtimet te kryera nga shpimet eshte konstatuar se niveli i ujerave nentokesor eshte poshte 10.0 m pervec ne tarracen e pare te lumit qe rezulton te jete 4.0-4.5 m nga siperfaqja e tokes. Brenda kesaj shtrese qarkullojne ujera te shumte nentokesor, per vete faktin se ajo paraqitet pa lidhje kohezionale. Kjo shtrese mbulohet nga suargjila deluviale me filtrueshmeri te ulet. Shtresa e suargjiles qe mbulojne shkembinjte rrenjesor kane nje filtrueshmeri shume te ulet dhe pikerisht ato qe pengojne ujerat e shiut si dhe siperfaqesor qe te deportojne ne shkembinjte rrenjesor. Shtresa e suargjiles ka nje filtrueshmeri shume te ulet dhe praktikisht nuk lejojne ujerat nentokesor te qarkullojne ne drejtim te shkembinjve rrenjesore.

Parametrat hidraulike te dherave ndryshojne nga nje sektor ne tjetrin per shkak te ndryshimeve te medha ne trashesine dhe menyren e formimit te tyre, por edhe te ndryshimeve te perberjes granulometrike dhe litologjike si ne drejtimgjeresor dhe ne ate gjatesor.

Lumi Ishëm rrjedh përmes Shqipërisë Qendrore (74 km i gjatë; sipërfaqja e pellgut është 673 km² dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit 357 m. Ai formohet nga bashkimi i Lumit të Tiranës, përrenjve Tërkuza dhe Zeza. Delta e tij ndodhet në Kepin e Rodonit (Kabo, 1990-91). Prurja

vjetore mesatare e Ishmit është 20,9 m³/s, me modul mesatar të rrjedhjes prej 31,0 l/s/km². Prurja maksimale është 1'980 m³/sek. Sasia kryesore e lëndëve të ngurta që transportohen në det është 2 milionë ton/vit. Ishmi ushqehet kryesisht nga ujëra sipërfaqësorë me mineralizim relativisht të lartë prej 461 mg/l. Temperatura e ujit luhatet nga 6,12 °C në janar deri në 24,7 °C në gusht. Ujërat e Ishmit përdoren për vaditje.

c) Nje identifikim te ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, toke, uje, ajer.

Metodika e identifikimit te ndikimeve te mundshme ne mjedis

Çdo veprimtari e re qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime qe jane pjese e kompromisit qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Vleresimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis si pasoje e zbatimit te projektit te propozuar eshte bere gjykuar mbi faktoret qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e funksionimit, sasine e energjise qe do te prodhohet, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjenerura, te gjitha nen kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis eshte analizuar sipas fazave te veprimtarise si me poshte:

– Ne fazen pergatitore/ndertimit

Cdo faze e zbatimit te projektit pervec ndikimeve te pergjithshme dhe te perbashketa ka edhe ato specifike qe varen nga faktoret qe i shkaktojne si p.sh. natyra e proceseve etj.

Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte dhe indirekte, per te vleresuar drejt ndikimet e cdo veprimtarie qe perdor burimet natyrore. Sipas natyres ndikimet klasifikohen ne dy grupe te medha:

– Ndikime te kthyeshme,

– Ndikime te pakthyeshe.

Te dy llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e ndikimit brenda siperfaqes se cdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve komplekse te natyres dhe rigjenerim te biodiversitetit.

Vete natyra e aktivitetit te propozuar dikton ndikime dhe efekte te perhershme ose ndikime mbetese ne karakterin e mjedisit te sapokrijuar pergjate gjithe teresise se tij, per zbutjen e te cilave propozohen masa konkrete.

d) Nje pershkrim te shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si , ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurme, si dhe prodhimin e mbetjeve

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

1. Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te kantierit te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
2. Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri dhe ujerat e zeza nga aktiviteti gjate shfrytezimit te kompleksit.
3. Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertohej.
4. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti, por edhe gjate funksionimit nga aktivitetet me muzike ne oret e vona, nese do te zhvillohen.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes. Gjithashtu djegia e lendes djegese, qe shkaktohet nga automjetet qe frekuentojne kete ambient, si dhe ne raste kur ka mungese te energjise elektrike dhe do te linde nevoja per ndezjen e gjeneratorit. Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve. Perdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit te siperfaqeve perreth, si dhe nga transporti i automjeteve te dheut te germuar apo te mbetjeve inerte te prodhuara gjate ndertimit. Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karroceria me mushama te posacme, si dhe te lahen rregullisht kur dalin nga kantieri i ndertimit dhe nga kantieri i prodhimit te betonit, te inerteve apo ne sheshin e depozitimit te dheut te germuar.

e) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuar

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vegmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

•*Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:*

- Mbrojtja e ajrit*
- Mbrojtja e ujerave*
- Mbrojtja e tokes*
- Mbrojtja e natyres*
- Ndryshimet klimatike*

Instalimi dhe funksionimi i aktivitetit, gjeneron mbetje sidomos gjate fazes se ndertimit. Investitori ne bashkepunim me expertin e mjedisit, do te marre masa per menaxhimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duke minimizuar gati ne eliminim efektet negative ne mjedis.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes se mjedisit*
- Parimi i zhvillimit te qendrueshem*
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake*
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore*
- Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit*
- Parimi i qasjes se integruar*
- Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit*
- Parimi "Ndotesi paguan"*
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut*
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit*

f) Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike ngavendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te

Ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance jo shume te gjere, me dhjetra ose qindra metra, pra ne nje distance jo me te larget se 200m. Ky ndikim do te jete i perkohshem dhe nuk eshte me veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate ujqor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e ndertimit dhe i perhershem nga ndertimi i strukturave mbi toke.

g) Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te siperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e meparshme, perfshire edhe token bujqesore, si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve ne këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësivë natyrore të trasheguara të mjedisit, mbrojtja e shendetit të punonjësve, mbrotja e cilësisë së ujrave nëntoksore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm ne harmoni me mjedisin. Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e

sistemimin e terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes së metejshme të tokës, për gjelbërimin e rigjelbërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shëndetin e mjedisit. Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike. Sistemimi i sheshit të ndertimit të objektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinierike të këtij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngushtë me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit. Shtresizimet e sipërfaqesore të sheshit midis elementeve të ndertimit të objektit, koridoret qarkulluese e të shërbimeve të mirëmbajtjes duhet të respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe e zënë nga ndertimet, si dhe rruga hyrëse duhet të restaurohet në rastin e ndikimeve të paevitueshme. Po kështu duhet të vepohet me të gjithë elementet jashtë objektit që mund të jenë ndikuar. Parashikimi i gjelbërimit në objekt nga projekti, si dhe rishikimi i gjelbërimit për shtimin e tij në të gjitha anët e objektit duhet të bëhet për të plotësuar sa më maksimalisht kërkesat përmirësuese e restauruese estetike dhe ekologjike por dhe për zbutjen e ndikimit nga zhurmat e stallës dhe aromave të pakëndeshme. Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore rurale janë në vartësi të volumit të kurores vegjetative të llojit, anës dekorative që prezanton si dhe dendësinë së përdorimit të llojit. Nga vëzhgimi i llojeve të zonës, mund të aplikohet mbjellja e plepit, shëlgut, frashërit, por dhe e bimeve perhere të gjelbërta si tuja, ilqja, dafina etj.

*Sistemimi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit.

Nderhyrja e parë që bëhet për rehabilitimin e vendit është sistemimi i tij, dhe sigurimi e ruajtja e vendit nga mosdëmtimi, gjatë punimeve rehabilituese.

h) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Plani i menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë zhvillimit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.

- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit , në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “Monitorim i gjendjes së mjedisit”;
- Ligjin Nr. 128/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10440 datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis:

Për ajrin duhet të monitorojë grimcat/gazet (PM10, PM2.5, SO2, NOx, CO2) dhe zhurmat (dB).

Për ujin, shkarkimet nga larja e makinerive/pajisjeve

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në Lejen Mjedisore dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto.

i) Ndikimet e mundshme në mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime nderkufitare, do te zhvillohet brenda territorit te vendit tone.

Ramazan Bodli
RB